Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/451
Datë: 26.07.2023

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060, për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ për Njohjen e Mësimit Paraprak (UA Nr. 31/2014, data 05.09.2014), dhe Udhëzimit Administrativ për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë (UA Nr.09/2019, data 18.06.2019), Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur më datë 19.07.2023 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Akreditohet** NEW BORN MASTER SH.P.K – rr."Xhavit Sylaj" 23000 Suharekë Republika e Kosovës , për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 23.06.2023 deri 22.06.2026, për zbatimin e Njohjes së Mësimit Praraprak (NjMP), me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK)

   1.1 **Murator dhe punëtorë të ngjashëm, Niveli III sipas KKK,** Iloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 16 kredi të AAP. IAAP mund të përfshijë në procesin e NJMP deri në tetë (8) kandidat brenda muajit, dhe gjatë një viti mund të vlerësohen deri ne nëntëdhjetë (96) kandidat nëpërmjet NjMP. Institucioni mund të zbatoj NjMP brenda këtij kualifikimi vetëm me këto module:

   - **1.1.1 Hyrje ne ndërtimtari, planifikimi dhe organizimi i punës me 2 kredi**
   - **1.1.2 Siguria, shëndeti në punë dhe mbrojtja e ambientit me 2 kredi**
   - **1.1.3 Leximi i projekteve dhe matjet teknike me 3 kredi**
   - **1.1.4 Muratimi i mureve me tulla dhe blloqe me 6 kredi**
   - **1.1.5 Muratimi i mureve ndarëse nga rigipsi me 3 kredi**

   Akreditim i institucionit për zbatimin e NjMP.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së NEW BORN MASTER SH.P.K, për akreditim të zbatimit të NjMP dhe rekomandimeve të dala nga raporti i ekipit të ekspertëve për akreditimin e institucioneve që zbatojnë NjMP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim për zbatimin e NjMP; Vendimit me nr.01/401 të datës 20.08.2021, Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. NEW BORN MASTER SH.P.K.;
2. Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK